



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 69, datë 07.02.2020

PËR

KOMANDIMIN E PËRKOHSHËM SI INSPEKTOR NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, TË MAGJISTRATES ZNJ.MARSELA PEPI

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 168, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 283, pika 10, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qe qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pas njoftimit dhe kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me Shkresën nr.14 prot., datë 03.02.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj.Marsela Pepi, për një periudhë 6-mujore.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistrates znj.Marsela Pepi sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR